

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit H. K., nga fshati S., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1390/2015 të datës 11.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Zejnulla Gashi, të akuzuarit dhe të dëmtuarit H. K.1, me date 04.12.2015 morri dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**H. K.**, nga i ati Sh. dhe nëna H., me mbiemër të vajzërisë L., data e lindjes..., në fshatin S., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, shqiptar, Shtetar i Republikës Kosovës.

## **ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 02.02.2015 rreth orës 09,44 minuta, në fshatin K., Komuna e Prizrenit, përmes telefonit me nr. +38 643 8xx xxx seriozisht i kanoset me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta të dëmtuarin H. K.1 pronar i ndërmarrjes, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke punuar në ndërmarrjen e tij, i pandehuri nëpërmjet telefoni i kanoset me fjalët “Harraqi niqin e psedhjet mij ero i ki afat mi ba sante deri në ora 8 në mbrëmje ju lutem për mirëkuptim bani paret dhe lajmrov ta tregoj vendin ku i bjen, mos ban lojna ose mashtrime se dënohesh ma shum”, dhe më pas pason sms tjetër me numër të njëjtë “Ora pot afrohet ti e din çka ban”, si dhe me fjalët “Dita tka kalu ora tka kalu ti te kje burr i fort spo nin për neve hiq spo lajmron kurrjë ta kqyrim kujt pi del ma mir ty apo neve fmit mos i nis për shkoll se nuk i sheh klm”, me ç ‘rast te i dëmtuari shkakton ankth dhe frikë,

Këso dore ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 par.1 pika 1.2, 45, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, te akuzuarit ia shqipton:

## **DENIM ME BURGIM**

Në kohë zgjatje prej 4 (katër) muajve,

I dëmtuari H. (B.) K.1, nga fshati S., Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1390/2015 të datës 11.06.2015, kundër të akuzuarit H. K., nga fshati S., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Zejnulla Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1390/2015 të datës 11.06.2015, të parashtruar ndaj të pandehurit H. K., nga fshati S., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-së, e tërë kjo ngase gjatë shqyrtimeve gjyqësore në mënyrë të plotë dhe të qartë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Kjo gjendje faktike është vërtetuar në bazë të deklaratave të vet akuzuarit, të dëmtuarit, dëshmitarëve si dhe provave tjera materiale, të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar që i akuzuari me të dëmtuarin janë kushëri, dhe se sipas deklaratës të vetë të akuzuarit dhe të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor këtu i akuzuari i ka ofruar të dëmtuarit blerjen e një trollit, gjegjësisht një pjesë të trollit, për çka i dëmtuari nuk ka qenë i interesuar. Po ashtu në mënyrë të qartë dhe të drejtë është vërtetuar që SMS kërcënuese që kanë arritur tek telefoni i të dëmtuarit me numër 044-1xx-xxx, kanë qenë të dërguara nga numri i SIM kartelës +386 43 8xx xxx, dhe se me rastin e administrimit të provës se në emër të kujt ka qenë ky numri i telefonit, vet i akuzuari ka theksuar që i njëjti ka poseduar edhe numrin e telefonit të telefonisë mobile IPKO dhe ate me numër 049 4xx xxx, të cilën deklaratë i akuzuari e ka dhënë në prezencë të avokatit të tij, në Stacionin policor, dhe me njoftimin sipas kërkesës të gjykatës nga telefonja mobile IPKO është konstatuar që numri i telefonit të kësaj kompanie dhe ate 049 4xx xxx ka qenë në aparatit e telefonit me numër të IMEI xxx, dhe se me të njëjtin aparat të telefonit me këtë numër të IMEI janë përdorur dy kartela të telefonit, kjo e telefonisë mobile IPKO dhe SIM kartela me numër 043 8xx xxx, numër ky i nën kontraktuesit ZOG Mobile, numër nga i cili edhe janë dërguar SMS-et të dëmtuarit, dhe ate me përmbajtje “harraqi njëqind e pesëdhjetë mijë euro, i ki afat me bo sonte deri në orën tetë në mbrëmje, ju lutem për mirë kuptim, boni paret dhe lajmëro ta tregoj vendin ku i bjen, mos bo lojna ose mashtrime se dënohesh më shumë”, dhe më pas ka pasuar SMS tjetër me numër të njëjtë, “ora po të afrohet, ti e din çka bënë”, si dhe në fund ka qenë dita ka kalu, ora të ka kalu, ti tek je buri fort, a po nin për neve, hiq spo lajmron kurgjo, ta kqyrim kujt pi del ma mirë, ty apo neve, fëmijët mos i nis për shkoll se nuk i sheh klm,” me çka të dëmtuari shkakton ankth dhe frikë. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga administrimi i provës të kompanisë IPKO dhe VALA dhe të administrimit të CD-es, ku vërtetohet të gjitha të cekurat më lart sa i përket numrit të telefonit, si dhe numri i IMEI të aparatit telefonik të vetë të akuzuarit, ku vet i akuzuari ka pranuar që i ka poseduar këto numrat të telefonit edhe të telefonisë mobile IPKO edhe të telefonisë mobile ZOG Mobile, dhe të aparatit telefonik me numër të cekur të IMEI i cili numër përputhet në tërësi me kartelat të cilat janë përdorur në të njëjtin.

Sa i përket deklaratës të vetë të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor si në fjalën hyrëse, po ashtu edhe në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit gjyqësor që i njëjti i ka humbur telefoni, dhe numrat e telefonit të cekur nga të cilat numrat janë dërguar SMS-at ndaj të dëmtuarit, dhe nuk i kujtohet as koha e as vendi se kur i kanë humbur, kjo mbrojtje është e pa bazë dhe ka për qëllim vetëm shmangien nga përgjegjësia penale, ngase në mënyrë të plotë nga provat e cekura më lart si ato të deklaratave të dëmtuarit dhe dëshmitarëve, e po ashtu edhe të administrimit të raporteve nga ana e kompanive mobile, si dhe gjetjet të hartografive nga ana e kompanive mobile lidhur me identifikimin e vendit nga ku janë dërguar SMS-at, si dhe numri i IMEI të aparatit telefonik, në mënyrë të plotë, të qartë dhe të saktë vërtetojnë figurën e kësaj vepre penale në bazë të elementeve të veprës penale të kanosjes nga ana e të akuzuarit në këtë çështje penale.

Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I dëmtuari H. K.1, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë si palë e dëmtuar kam përjetuar frikë, ankth dhe dhimbje shpirtërore, në përmbajtjen e SMS-ave që më kanë ardhur në telefon. Ka qenë e pa përshkruar gjendja e përgjithshme e familjes, së pari si prind e kam ndie vetën tepër rëndë në kuptimin që mos ti lëshoj fëmijët në shkollë, andaj pa marr parasysh tek kush ka mund të jetë apo është, qoftë ai edhe vëllau im, i propozoj gjykatës që të shqiptoj dënim meritor, e tërë këtë në bazë të fakteve dhe provave, e sa i përket kërkesës pronësoro juridike, deklaroj që parashtoj të njëjtën, e për lartësinë e të cilës do ti precizoj në kontestin e rregullt civil.

I akuzuari H. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë personalisht mundem në fjalën përfundimtare të përsërisë edhe një herë si në fjalën hyrëse, si në mbrojtjen time edhe tani në fjalën përfundimtare, që mua personalisht më ka humbur telefoni, ekziston mundësia që dikush të ketë dërguar SMS kërcënuese këtu të dëmtuarit H. K.1, kur unë jam i bindur dhe mund të betohem që unë personalisht të njëjtat nuk i kam dërguar.

Unë të dëmtuarin e kam kushëri dhe ate babat tanë janë djemtë të axhës, kurrë me të njëjtin nuk kam pasur ndonjë mosmarrëveshje kemi ndajtur bashkë nëpër ndeja familjare, por që nga momenti i këtij rasti më raportet tona janë ngrirë, unë edhe një herë theksoj që unë nuk jam ai që i ka shkruar këto mesazhe, ngase nuk kam pasur arsye të kryej këto veprime, telefoni im më ka humbur, kurrë dhe ku nuk e di, dhe ka mundur dikush tjetër të manipuloj dhe të dërgoj të dëmtuarit H.1. mesazhe me këto përmbajtje, përmbajtjet e të cilave kanë shkaktuar frikë, ankth te i njëjti, dhe me këto veprime të ketë kryer veprën penale e cila më vihet në barë mua.

Në fund më vije keq për tërë këto përjetime që i ka përjetuar i dëmtuari, të cilin e kam kushëri si ceka më lart, dhe i propozoj gjykatës që të vendos në bazë të provave dhe ligjit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 02.02.2015 rreth orës 09,44 minuta, në fshatin K., Komuna e Prizrenit, i akuzuari, përmes telefonit me nr. +38 643 8xx xxx seriozisht i kanoset me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta të dëmtuarin H. K.1 pronar i ndërmarrjes, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke punuar në ndërmarrjen e tij, i pandehuri nëpërmjet telefoni i kanoset me fjalët “Harraqi niqin e pesdhjet mij ero i ki afat mi ba sante deri në ora 8 në mbrëmje ju lutem për mirëkuptim bani paret dhe lajmrov ta tregoj vendin ku i bjen, mos ban lojna ose mashtrime se

dënohesh ma shum”, dhe më pas pason sms tjetër me numër të njëjtë “Ora pot afrohet ti e din çka ban”, si dhe me fjalët “Dita tka kalu ora tka kalu ti te kje burr i fort spo nin për neve hiq spo lajmron kurrjë ta kqyrim kujt pi del ma mir ty apo neve fmit mos i nis për shkoll se nuk i sheh klm”, me ç ‘rast te i dëmtuari shkaktonte ankth dhe frikë,

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate deklaratës akuzuarit, deklaratës të dëmtuarit, deklaratave të dëshmitarëve dhe ate N. B., Z. K., F. H., F. Sh., I. T., dhe provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe ate raportit e oficerit policor me numër 2015 GA 0300, të datës 03.02.2015, 16.03.2015 dhe 18.03.2015, të përpiluar nga zyrtarët policor F. H. dhe Z. K., informacioneve të kompanisë IPKO me numër 41,457,324-2,850/2,974-2 të datës 29.04.2015, 31.03.2015, 04.03.2015 dhe 03.03.2015, 24.02.2015 dhe 02.09.2015, informacionit të PTK-ës me numër ZKL 408/15 të datës 23.02.2015, ZKL nr.455/15, në informacionet e Z Mobile të datës 10.03.2015, nga deklarata e të dëmtuarit, të dhënë pranë Stacionit policor në Prizren, me datë 03.02.2015, deklarata e dëshmitares N. B. të dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 06.02.2015, deklarata e të pandehurit të dhënë në procedurën paraprake në Stacionin policor në Prizren me datë 18.03.2015 dhe 22.05.2015, dhe dy CD-eve dhe ate CD të Z Mobile me numër 98 dhe CD Vala 455/15, pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike. Nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësinë penalo juridike të akuzuarit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit H. K.1 i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 28.09.2015, deklaroi, me datë 02.02.2015 në ora 09,44 minuta, më ka ardhur mesazhi i parë telefonik – SMS, me përmbajtje “haraqi njëqind e pesëdhjetëmi Euro i ki afat mi ba sonte deri në ora tetë në mbrëmje, ju lutem për mirëkuptim, bani paret dhe lajmëro të tregoj vendin ku i bjenë, mos bon lojna ose mashtrime se dënohesh më shumë”. Me të njëjtën ditë në ora 16,25 pason SMS e dytë dhe ate “ora po të afrohet, ti din çka bënë”, ndërsa me datë 03.02.2015 në ora 10,33 minuta vjen mesazhi në telefonin tim me fjalët “dita tka kalu ora tka kalu ti je buri fort spo nin për neve hiq spo lajmëron kurgjo ta kqurim kujt pi del ma mirë ty apo neve, fëmijët mos i nis për shkoll se nuk i sheh klm”, ndërsa me datën 04.02.2015 në ora 17,45 më ka ardhur edhe mesazhi i katërtë – SMS dhe ate me përmbajtje “o paidh kurve të ka ardhur fundi”, të katër mesazhet janë dërguar nga numri i njëjtë dhe ate nga numri +386 43 8xx-xxx, në numrin tim të telefonit personal mobil me numër 044/1xx-xxx. Të pandehurin H. K. e kam kushëri të parë dhe atë babai i babait tim dhe babai i babait të pandehurit H. kanë qenë vëllezër nga babai, çka nënkupton që babai i gjysheve tonë ka qenë i martuar dy herë dhe ata kanë qenë vëllezër nga babai. Unë me H. nuk kam pasur kurrfarë mosmarrëveshje lidhur me ndonjë borxh, absolutisht kurë dhe asnjëherë nuk i kam pasur borxh H., e as personave fizik nuk ju kam pasur kurrë borxh. Në një nga deklaratat e dhëna në Stacionin policor, më kanë paraqitur në shikim fotografën e këtu të pandehurit. Këtë fotografi ma kanë prezantuar hetuesit në stacionin policor, dhe më kanë thënë që H. K. ka pranuar vet në stacionin policor që numri i telefonit nga i cili kam pranuar unë mesazhet ka qenë i tij më përpara dhe i njëjti në ndërkohë i ka humbur, si dhe telefoni. Pas këtij njoftimi unë e kam ftuar këtu të pandehurin H. në shtëpinë time dhe i kam treguar lidhur me njoftimin nga zyrtarët e policisë. I njëjti ka ardhur së bashku me vëllaun e tij A. K., dhe më ka thënë “nëse unë jam ai që të kam shkruar këto mesazhe – SMS të marr besë për një gjak”, nuk ka pranuar kurrësesi para meje që ai është dërguesi i mesazheve. Nuk më kujtohet saktë data se kurë ka qenë dita kur kam dërguar dhe jam njoftuar që këtu i pandehuri H. i ka dërguar këto mesazhe.

Pas shqyrtimit të kaluar pranë kësaj gjykate me datë 14.09.2015, pasi që kemi arritur në shtëpinë tonë, bashkëshortja ime M. K., më ka njoftuar që nëna e të akuzuarit H., H. K. i ka thënë shoqës time “kur e ka marr vesh H.1, që H. i ka dërguar mesazhet – SMS-at, është dashur ta ndërpres menjëherë këtë çështje, më mirë është ta ndërprejë tani menjëherë, se mund të bëhet më keq”. Unë personalisht nuk mund të dyshojë as tash as nuk mund të garantojë që këtu i akuzuari H. më ka dërguar mesazhet, por kam dëshirë dhe vullnet dhe i propozoj gjykatës që kush qëndron mbrapa këtyre mesazheve kërcënuese, të vërtetohet nga gjykata me ndihmën e ekspertëve të telefonive mobile, nëpërmjet secilit mjet të mundshëm që shërben për vërtetimin e këtyre mesazheve gjegjësisht se kush ka dërguar këto SMS, qoftë ai individ, apo ndonjë grup.

I dëmtuari në fund shton që deri sa nuk vërtetohet se kush ka dërguar SMS kërcënuese në numër tim të telefonit, as unë personalisht, e as anëtarët e familjes sime të ngushtë nuk e ndiejnë veten të qetë. Kam pasur edhe thirrje tjera nga numrat tjerë telefonik, jo SMS po thirrje dhe atë sa më duket kanë qenë operatori mobil Z Mobile, për të cilat thirrje janë të njoftuar zyrtarët policor.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 28.09.2015, dëshmitarja N. B., unë jam pronare e një marketit në fshatin S., Komuna e Suharekës. Pos produkteve të ndryshme shesim edhe numra edhe mbushje të telefonive mobile. Shesim numra të telefonisë mobile IPKO, dhe mbushje të telefonive mobile IPKO, vala, ndërsa në një periudhë në muajin janar, më kujtohet ka qenë mesi i muajit janar, apo edhe pjesa e parë muajit shkurt, më kanë sjellë numra edhe telefonia mobile “Zog Mobile”, të njëjtit zyrtarë më kanë sjellë rreth 30 numra, dhe më nuk kam bashkëpunuar me ata, pas shitjes së këtyre 30 numrave. Unë si theksova kam shitur vetëm një sasi të numrave të telefonisë mobile Zog Mobile, dhe atë në sasi prej 30 numrave, dhe më e kam ndërprerë bashkë punimin me të njëjtit, pasi që nuk kanë ardhur për të më sjellë numrat apo mbushje tjera. Saktësisht nuk më kujtohet që këtu H. K. të ketë blerë ndonjë numër të telefonisë mobile Zog mobile në marketin tim. Unë në marketin tim “E.-a.”, në fshatin S., praktikoj që nga konsumatori me rastin e shitjes së numrit të telefonisë mobile, i kërkoj letërnjoftimin dhe nga ai marr numrin personal, numrat nga Zog Mobile i kam të regjistruara në një listë, për ndryshe libër shitjes, të cilën më kanë sjellë vetë zyrtarët e Zog Mobilës. Në fillim të bashkë punimit me telefonin mobile Zog Mobile, kam bërë regjistrin, por pas kësaj zyrtarët e të njëjtës më nuk më sillnin mbushje, dhe për këtë edhe e ndërpreva bashkë punimin me të njëjtit, e po ashtu edhe më nuk regjistroja dhe nuk merrja shënime për persona që blenin numra të telefonisë mobile Zog Mobile. Nuk mund të deklarohej sa ka qenë numri i blerësve të numrit të telefonit të Zog Mobile apo të mbushjes për të njëjtën, por mundem ta sjelli librin e shitjeve të numrave të telefonit për Zog Mobile.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 29.09.2015, në vazhdim të deklaratës së saj dëshmitarja N. B. deklaron: kemi marr 30 numra të telefonit, kemi pasur një marrëveshje gojore ne dy vajza të cilat kanë ardhur në marketin tim “E.-A.” në S., dhe janë prezantuar si zyrtare të telefonisë mobile Zog mobile, më kanë ngarkuar me 30 numra të telefonit, të cilat unë kam pasur në dispozicion që ti shes, dhe çdo shitje që kam bërë, kam evidentuar në librin e shitjeve të cilën ma kanë dhënë vetë zyrtarët e cekura, por duke pasur parasysh që të njëjtat më nuk kanë ofruar mbushje për telefonat e kësaj kompanie, në një farë mënyrë në mënyrë të heshtur është bërë ndërprerja e këtij bashkëpunimi, unë më nuk kam bërë regjistrimin e personave të cilëve ju kam bërë shitjen e numrave telefonik të kompanisë të telefonisë mobile Zog Mobile. Sot gjykatës i parashtraj edhe formularin – regjistrimin e personave të cilat unë posedoj që ju kam shitur

numrat e telefonave, në të cilin regjistër figurojnë emrat, mbiemrat numrat personal dhe numri i telefonit të shitur.

Prokurori i shtetit pas pranimit të formularit – regjistrimit të telefonisë mobile Zog Mobile, të cilën sot e parashtron dëshmitarja, lidhur me evidentimin e personave të cilët janë furnizuar me numrat të telefonit të kompanisë mobile Zog Mobile, dhe shikimit të të njëjtit, prokurori i shtetit bënë vërejtje në të njëjtën dhe atë në drejtim të mos regjistrimit në mënyrë kronologjike të datave të shitjes, si dhe mos regjistrimit të 30 numrave me të cilat e njëjta ka qenë e ngarkuar, sipas vet deklaratës së saj, ngase në formular qëndrojnë vetëm 15 emra, ndërsa 15 numra të tjerë nuk janë të evidentuar se kujt dhe kur janë shitur.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 29.09.2015, dëshmitari zyrtari policor Z. K., deklaron: Unë si zyrtarë policor, gjatë punës sime në Stacionin policor në policinë regjionale në Prizren, me datë 03.02.2015, është paraqitur qytetari H. K.1, dhe i cili na ka njoftuar për mesazhet telefonike të pranuar me datë 02.02.2015 dhe me datë 03.02.2015. në bazë të kësaj, kemi filluar hetimet dhe fillimisht me datën 05.02.2015, kemi kërkuar nga Prokuroria urdhëresë për zbatimin e masave të fshehta dhe atë në drejtim të përgjimeve të bisedave dhe mesazheve telefonike të numrit nga i cili janë dërguar mesazhet këtu të dëmtuarit H. K.1 dhe atë të numrit +386 43 8xx xxx. Nga datat 05.02.2015 deri me datën 18.02.2015 kemi zbatuar masat e fshehta dhe kemi kërkuar nga kompania e telefonisë mobile IPKO të gjitha hyrjet dhe daljet nga ky numër si të telefonatave, ashtu edhe mesazheve – SMS. Nga të dhënat që na ka ofruar telefonia mobile IPKO, ka regjistruar që numri nga i cili janë dërguar mesazhet – SMS të dëmtuarit ka pasur vetëm 3 ditë dalje të mesazheve dhe me këto tre ditë të njëjtat janë dërguar në telefonin e këtu të dëmtuarit, ndërsa nuk ka pasur asnjë telefonat tjetër.

Kemi kërkuar nga zyrtarët e telefonisë mobile IPKO, identifikimin e IMEI, numrin identifikues të telefonit ku ka qenë kartela me numrin +386 43 8xx xxx, dhe nga të njëjtit kemi marr informacion që në këtë telefon kanë qenë dy numra të telefonit dhe atë numri i telefonit +386 43 8xx xxx të telefonisë mobile Zogu dhe numri +386 49 4xx xxx të telefonisë mobile IPKO. Po ashtu të njëjtit na kanë dhënë edhe informacionet që numri telefonik i kompanisë të telefonisë mobile IPKO që ka qenë i vendosur në telefonin e H. K., në bazë të identifikimit IMEI, numrin e cekur e ka blerë në kompaninë IPKO H. K.

Po ashtu edhe në përshkrimin e veprës penale të kallëzimit penal në faqen e dytë në mënyrë të qartë specifikohet që numri i telefonit 044 1xx xxx, pronë e të dëmtuarit H. K.1, gjatë periudhë kohore duke filluar nga data 02.02.2015 në ora 09,44 - 09,45 deri me datën 04.02.2015 në ora 17,45 – 17,53, i njëjti është përdorur nga aparati i telefonit me IMEI xxx. Po ashtu është theksuar që telefoni me IMEI të akuzuarit është përdorur për të dy kartelat si ceka më lart, e po ashtu i dyshuari H. K. ka deklaruar se poseduesi i numrit të telefonit 049-4xx-xxx ka qenë i tij, dhe ky numri i telefonit së bashku me aparatin e telefonit i ka humbur para disa muajve.

Gjatë hetimeve në këtë çështje penale, ne kemi kryer edhe veprimet tjera hetimore dhe atë kemi kërkuar nga telefonia mobile IPKO njoftimin se kush është posedues i numrit të telefonit +386 43 5xx xxx, dhe të njëjtit na kanë njoftuar me shkrim me datë 03.04.2015 se numri i kërkuar nuk është i regjistruar në emër të personit i cili ka blerë numrin e cekur më lart, por na kanë siguruar pikën e shitjes se ku është shitur numri i kërkuar, dhe ka rezultuar që është biznesi D.P.T “E.-A.”, në fshatin S. Komuna e Suharekës.

Pas këtij informacioni ne kemi shkuar në pikën e shitjes dhe kemi takuar pronaren N. B. nga fshati S., e cila na ka njoftuar lidhur me kërkesën tonë që nuk ka evidencë të plotë të personave që ju ka shitur numrat e telefonave të kompanisë të telefonisë mobile Zogu, por ka theksuar që këtë lloj të numrave të kësaj kompanie mobile më së shpeshti ka blerë Q. J. nga fshati S., të cilin person ne kemi intervistuar dhe kemi verifikuar nëpërmjet numrit IMEI të tij të telefonit që i njëjti ka shfrytëzuar diku 10 numra të telefonisë mobile Zogu, por asnjëri nga ata nuk ka qenë numri nga i cili janë dërguar mesazhet SMS këtu të dëmtuarit, i njëjti ka pasur disa biseda tjera me numra të tjerë.

Po ashtu vlen të theksohet që në deklaratën me datë 18.02.2015 këtu i dyshuari në pyetjen se numri i telefonit nga i cili është dërguar mesazhi – SMS tek i dëmtuari a e ka pasur ndonjëherë në posedim, i njëjti ka deklaruar që si numër më kujtohet që e kam pasur në posedim, dhe se kam blerë para 5-6 muajve dhe pas harxhimit të kredisë të njëjtën pastaj e kam hedhur dhe më nuk e kam në posedim, dhe sa është kujtuar të njëjtit këtë numër të telefonit e ka blerë në fshatin S., gjithmonë është fjala për numrin +386 43 8xx xxx.

Po ashtu në deklaratën me datë 22.05.2015, i dyshuari këtu i akuzuar thekson që numër të telefonit 049 4xx xxx, e ka poseduar deri para 5-6 muajve këtë numër, mirëpo ky numri i telefonit së bashku me aparatit e telefonit i kanë humbur.

Po ashtu nga të cekurat e më larta vjen përfundimi që në të dy deklaratat dhe ato me datë 18.02.2015 dhe 22.05.2015, i njëjti deklaroi në mënyrë identike që ka pasur në posedim apo ka qenë poseduesi të njëjtit sa i kujtohet të numrit +386 43 8xx xxx, e po ashtu edhe në deklaratën e dytë kur është pyetur për numrin 049-4xx-xxx, thekson që deri para 5 - 6 muajve e ka pasur në posedim dhe se të njëjtin me numër dhe me telefon e ka të humbur, çka rezulton që të dy numra të telefonit të cekura të njëjtat sipas deklaratës së këtu të akuzuarit i ka pasur në posedim 5 – 6 muaj më herët, dhe të njëjtat numra me telefon i ka humbur.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 02.12.2015, zyrtari policor Z. K. deklaroi: në pyetje të akuzuarit se në bazë të cilës provë është bazuar lidhur me deklaratën e datës 18.03.2015, se deklarata e cituar është bërë gjatë intervistimit të të dyshuarit këtu të akuzuarit H. K., fjala është për deklaratën e parë të dyshuarit të dhënë në stacionin policor në Prizren në praninë të mbrojtësit të tij avokat D. R.

Në deklaratën e cekur, të cilën e kemi marrë pasi që paraprakisht nga telefonja mobile IPKO kemi kërkuar identifikimin e aparatit telefonik IMEI xxx, për periudhën kohore prej datës 30.01.2015 deri me datën 14.02.2015, dhe është pranuar raporti nga telefonja mobile IPKO që në këtë periudhë kohore në këtë aparat telefonik janë përdorur dy SIM kartela dhe ato SIM kartela me numër të telefonit +386 43 8xx xxx dhe +386 049 4xx xxx,

Në vazhdim të intervistimit kam parashtruar edhe pyetjen a ka qenë numri juaj i telefonit 043 8xx xxx ndonjëherë pronë e juaja, i njëjti më është përgjigjur që sa më kujtohet si numër e kam pasur në posedim, e kam blerë para 5-6 muajve, dhe pas harxhimit të kredisë të njëjtin e kam hedhur.

Unë gjatë punës ime profesionale pas përpilimit të deklaratës, të njëjtën i dorëzoj të dyshuarit në lexim, dhe i njëjti pas leximit e nënshkruan, në rastin konkret këtu i akuzuari ka pasur kohë të mjaftueshme që deklaratën ta lexoj, dhe nuk ka pasur kurrfarë vërejtje pas leximit,

dhe të njëjtën e ka nënshkruar, deklarata e juaj e përpiluar me datë 18.03.2015, ka qenë e përpiluar në bazë të fjalëve tuaja, si dhe në të njëjtën deklaratë ka marr pjesë edhe avokati juaj D. R. Të gjitha pyetjet që i kam parashtruar, dhe përgjigjet e juaja janë përpiluar me shkrim, të cilën deklaratë edhe ju vet pas leximit e keni nënshkruar dhe ate si theksova më lart në prezencën e avokatit juaj D. R.

Në fund theksoj që deklarata e të akuzuarit H. K., të dhënë në Stacionin policor me datë 18.03.2015, në tërësi përputhet edhe me mendimin dhe përshkrimin e të gjeturave nga zyrtarët e telefonisë mobile IPKO, sa i përket perimetrit të vendit dhe periudhës kohore në të cilën janë dërguar SMS-a kërcënuese këtu të dëmtuarit, si dhe përfundimi i tërë kësaj është që dy kartelat dhe ate me numrat 043 5xx xxx dhe 049 4xx xxx, janë përdorur në aparatit e telefonit me numër IMEI xxx, që do të thotë që ky numër i IMEI është në përputhje të plotë me numrin e IMEI-it të telefonit të akuzuarit.

Numri i IMEI-it i cekur më lart, ka qenë numri me të cilin telefon është përdorur kartela e telefonit 049 4xx xxx, të cilin numër e pranon edhe vet i akuzuari që e ka poseduar, e sipas raportit të telefonisë mobile IPKO në aparatit telefonik me këtë numër të IMEI është përdorur edhe SIM kartela me numër 043 5xx xxx. Po ashtu i akuzuari ka deklaruar që ky numër i aparatit telefonik së bashku me numrin dhe SIM kartelën 049 4xx xxx, i kanë humbur. Po ashtu rezulton që numri 043 5xx xxx është përdorur vetëm për dërgimin e SMS-ave në numrin e telefonit 044 1xx xxx, numër ky i të dëmtuarit. Përveç katër SMS-ave të dërguara, në numrin e të dëmtuarit, numri 043 5xx xxx nuk ka pasur kyçje tjera në rrjetin e telefonisë mobile.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 22.10.2015 dëshmitari zyrtari policor F. H., deklaron: Me datë të saktë nuk më kujtohet, ka qenë diku fillimi i vitit 2015, me bindje time ka qenë muaji shkurt, kur në Stacionin policor është paraqitur i dëmtuari H. K.1 dhe na ka njoftuar që i njëjti ka pranuar disa SMS me përmbajtje kërcënuese ndaj tij personalisht dhe ndaj familjes, konkretisht përmbajtja e saktë nuk më kujtohet, dhe mua si zyrtarë në cilësinë e eprorit të njësisë të hetimeve në Stacionin policor Prizren më është kërkuar të filloj hetimet preliminare lidhur me paraqitjen e të dëmtuarit. Me rastin e ndërmarrjes të veprimeve së para fillestare, kam konstatuar nga përmbajtja e SMS-ave, që është fjala për një shumë të madhe të hollave, janë cekur sa më kujtohet shifrat për tej një qind mijë eurove në formë të një lloj shantazhi, andaj duke e parë lartësinë e shumës së kërkuar, konform rregullave tona të njëjtën çështje penale e kemi ceduar pranë drejtorisë regjionale në Prizren, dhe këtë për arsytet që ne si stacion policor Alfa, merremi me shuma deri në 15.000 Euro, e me rastin e tejkalimit të kësaj shume kompetent janë zyrtarët pranë njësisë e hetimeve në drejtorinë regjionale.

Nga të cekurat sipas procedurës tonë ne së pari bëjmë regjistrimin në regjistrin tonë kompjuterikë, dhe pas kësaj varësisht nga pesha dhe rëndësia e veprës penale, lëndën i cedojmë departamenteve – sektorëve të caktuara. Nga të cekurat, duke parë peshën e kësaj vepre penale, dhe parandalimin e ndonjë pasojë më të madhe, pas regjistrimit të lëndës si çështje penale, këtë e kemi ceduar pranë drejtorisë rajonale të policisë në Prizren. Lënda është dërguar të nesërmen, ngase obligimi ynë është që brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes të veprës. Detyra ime në kuadër të kompetencave të mia në këtë çështje penale ka përfunduar në momentin e dërgimit të çështjes pranë drejtorisë regjionale në Prizren. Po paraprakisht kërkojmë mendimin e të dëmtuarit për ndonjë të dyshuar sipas vetë të dëmtuarit. Po e kam pyetur dhe nga i njëjti kam marr përgjigje që nuk dyshon në askënd, dhe i njëjti deklaron që nuk ka pasur të keqe me askënd.



Në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.10.2015, përfaqësuesi i telefonisë mobile IPKO F. Sh., zyrtarë në njësinë për çështje juridike dhe rregullator pranë telefonisë mobile IPKO, deklaron: duke vepruar sipas urdhëresës të kësaj gjykate me datë 29.09.2015, lidhur me sigurimin e raportit lidhur me emrin dhe mbiemrin e pronarit të numrit të telefonit +386 43 8xx xxx dhe hartografisë për numrin e njëjtë dhe atë në periudhën 26.01.2015 deri me datën 22.02.2015, gjykatës i parashtron dy raporte dhe atë raportin lidhur me planifikimin në çasjës në rrjet me numër 4501 të datës 22.10.2015, si dhe raportin ligjor me numër 2540-2 të datës 28.09.2015, ku në mënyrë detale është e përshkruar sqarimi për funksionimin dhe terminologjinë e rrjetit mobil, përshkrimi i lokacioneve nga hartografia, si dhe përshkrimi i lokacioneve në hartë, për të cilat në mënyrë më detale mund ti sqaroj eksperti i planifikimit të rrjetit, i cili është i punësuar në cilësinë e inxhinierit pranë telefonisë tonë mobile.

Ne si telefoni mobile IPKO afarizmin tonë e kemi si operator i telefonisë mobile, dhe gjatë afarizmit tonë, kemi marrëveshje me anë të kontratave të cilat na shërbejnë për furnizimin e kompanive të ndryshme me numrat telefonik për shitje e të njëjtëve. Në këtë mënyrë ne kemi furnizuar T. H. G. SHPK me seli në fshatin L. Komuna e Graçanicës, me pronar R. K., me numër të regjistrimit të biznesit..., të cilit i kemi dhënë në disponim një numër të konsiderueshëm të numrave telefonik. I njëjti ka pasur të drejt gjatë afarizmit të tij që këta numra të ju dorëzoj në disponim edhe distributorëve të tjerë, andaj rasti është kur i njëjti i ka dorëzuar në dispozicion distributorit në këtë rast E. A. në fshatin S. Obligim i SHPK T. H. G., është që me rastin e shitjes të numrave, gjegjësisht të SIM kartelave, të na njoftoj për personat të cilët janë bërë pronar të të njëjtave, të cilën gjë i njëjti e kërkon edhe nga distributorët e tij. Në rastin konkret numri i telefonit +386 43 8xx xxx, gjatë regjistrimit të numrave me hyrje 043, ne kemi ardhur në përfundim dhe për këtë edhe ju kemi informuar në bazë të raportit me shkrim të datës 28.09.2015, që ky numër është shitur në pikën e shitjes DPT E. A. në qytetin e Suharekës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.10.2015, në cilësi e dëshmitarit është dëgjuar I. T., deklaron: Qëndroj në tërësi si në raportin të parashtruar kësaj gjykate me datë 22.10.2015, dhe theksoj që nga të gjeturat tona duke vepruar sipas urdhëresës të kësaj gjykate kemi gjetur që me datën 02.02.2015, janë dërguar SMS-et në numrin 044-1xx-xxx, në ora 09,44 minuta, dhe sipas hartografisë tonë vendet – celulat kanë mbuluar pjesën hyrëse të fshatit M., fshatin S., në pjesë të fshatit Sa., dhe fshatit D. të Komunës së Suharekës.

Me datën 02.02.2015 janë dërguar SMS-et në numrin 044-1xx-xxx, në ora 09,44 minuta, dhe sipas hartografisë tonë vendet – celulat kanë mbuluar pjesën hyrëse të fshatit M., fshatin S., në pjesë të fshatit Sa., dhe fshatit D. të Komunës së Suharekës,

Me datën 02.02.2015 janë dërguar SMS-at në numrin 044-1xx-xxx, në ora 16,25 minuta, dhe sipas hartografisë tonë vendet – celulat kanë mbuluar fshatin Sa., D. dhe B. të Komunës së Suharekës,

Me datën 03.02.2015 janë dërguar SMS-et në numrin 044-1xx-xxx, në ora 10,33 minuta, dy SMS-sa, ndërsa në po të njëjtën ditë i njëjti numër ka pranuar SMS për njoftim thirrje e humbur dhe ate në ora 22,26 minuta 3 njoftime për thirrje të humbura, dhe sipas hartografisë tonë vendet – celulat kanë mbuluar pjesën hyrëse të fshatit M., fshatin S., në pjesë të fshatit Sa., dhe fshatit D. të Komunës së Suharekës

Me datën 04.02.2015 është dërguar SMS në numrin 044-1xx-xxx, në ora 17,45 minuta, dhe se sipas hartografisë tonë vendet celulat kanë mbuluar fshatin Sa., D. dhe B. të Komunës së Suharekës.

Po ashtu në vazhdim të këtij raporti është edhe përshkrimi i lokacioneve në hartë. E po ashtu në faqen e 3 paraqitet edhe funksionimi dhe terminologjia në rrjetin mobil në mënyrë skematike.

Sa i përket raportit të datës 28.09.2015, i njëjti është po thuaj se identik në kuptimin dhe tërësinë e saj, me raportin e parashtruar dhe të përshkruar më lart.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 02.12.2015, është bërë leximi i shkresave dhe atë leximi i raportit të oficerit me numër 2015 GA 0300 të datës 03.02.2015, 16.03.2015 dhe 18.03.2015, të përpiluar nga oficerët F. H. dhe Z. K. leximi i informacioneve të kompanisë IPKO, me numër 41,457,324-2850/2,974-2 të datës 29.04.2015 dhe 31.03.2015, 04.03.2015 dhe 03.03.2015, 24.02.2015 dhe 02.09.2015, leximi e informacionit të PTK-ës me numër ZKL 408/15 të datës 23.02.2015, ZKL numër 455/15, në informacionin e Z Mobile të datës 10.03.2015, leximi në deklaratën e të dëmtuarit të dhënë pranë Stacionit policor në Prizren, me datë 03.02.2015, leximi në deklaratën e dëshmitarës N. B., të dhënë në stacionin policor në Prizren me datë 06.02.2015, leximi në deklaratën e të pandehurit të dhënë në procedurën paraprake në stacionin policor në Prizren me datë 18.03.2015, dhe me datë 22.05.2015, shikimi në foto dokumentacionin që janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës. si prova në plotësim të procedurës së provave janë lexuar edhe dy CD dhe atë CD Z Mobile nr.98, dhe CD Vala 455/15,

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 02.12.2015, i akuzuari H. K., në mbrojtjen e vet i njëjti deklaron: po kam dhënë dy deklarata në Stacionin policor para zyrtarit policor Z. K. Në deklaratën më kujtohet ka qenë prezent edhe avokati D. R., kam vërejtje në të dy deklaratat, dhe atë që unë nuk kam deklaruar ashtu si është theksuar në deklarata, kam vërejtje në deklaratën e dhënë me datën 18.03.2015, dhe atë në drejtim të numrit 043 8xx xxx, ku deklaroj që nuk është i imi, e jo siç figuron në procesverbalin e cekur, unë kam cekur për posedimin e numrit të telefonit 049 4xx xxx, nuk më kujtohet çka kam deklaruar at ditë, pasi që ka kaluar një periudhë kohore.

I akuzuari pas leximit të deklaratës të dhënë nga vet ai në Stacionin policor, i njëjti deklaron që është e saktë deklarata e lexuar në shqyrtimin gjyqësor, pos vërejtjeve që i bëra më lart, e po ashtu pas dhënies në shikim të procesverbalit të cekur i njëjti deklaron, po nënshkrimi në pjesën e poshtme në anën e majtë është i imi.

Deklarata është e saktë, dhe qëndroj në tërësi pranë të njëjtës të dhënë me datë 22.05.2015, dhe të njëjtën e kam nënshkruar pa vërejtje.

Deklaroj edhe një herë që telefonin e cekur me numrin e cekur 049 4xx xxx e kam humbur, dhe atë pak para vitit të ri 2015 diku në fund të vitin 2014, ku, si më ka humbur ky numri i telefonit unë nuk e di, diku dy muaj para fundit të vitit 2014 pra fjala është për muajin tetor apo nëntor të vitit 2014.

Kam pasur borxhe në muajin mars, dhe të njëjtat i kam paguar. Tani për tani e kam gjendjen e mirë financiare, punoj në ndërtimtari.

Numrin 049 4xx xxx, e kam blerë në marketin “V. H.”, në fshatin Sa., Komuna e Suharekës, dhe të njëjtin e kam përdorur për afërsisht një vit derisa më ka humbur diku ka fundi i vitit 2014.

E di që mu telefoni më ka humbur së bashku me numrin 049 4xx xxx, si thashë në fund të vitit 2014, e si ka mundur numri 043 8xx xxx, të kyçet në rrjet nëpërmjet telefonit tim, këtë nuk mund ta shpjegoj.

Unë theksova që punoj në ndërtimtari, dhe e di që ka qenë fundi i sezonit, e kam mbledhur mjetet e mia të punës së bashku me materialin ndërtimor që na ka mbetur pas përfundimit të sezonës, dhe e di që telefonin herën e fundit e kam pas në placin ku i lë mjetet e punës, në fshatin tim Sa., në oborr i cili oborr është në sipërfaqe prej 3 hektar, dhe aty kam qenë me 4 punëtorët e mi që punojnë me mua punë ndërtimtare. Në atë moment, kam vërejtur që nuk e kam telefonin, dhe i kam pyetur edhe punëtorët, por asnjëri nuk ka ditur të më përgjigjet. Atëherë kam kuptuar që më ka humbur telefoni.

Nuk është e vërtetë që bisedat për shitje të trollit tim, të dëmtuarit i kam bërë në muajin janar, por bisedat për shitjen e trollit, i kam bërë me të dëmtuarin në muajin shkurt dhe atë kohë mesazhi i muajit shkurt 2015, lidhur me këtë datë gjegjësisht në këtë periudhë kam edhe dëshmitar.

Unë kam edhe dëshmitar për këtë që themë, dhe mund të themë me bindje të plotë se tërë bisedën për shitjen e trollit e kam pas në fund të muajit shkurt 2015.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata në mënyrë të plotë dhe të saktë e vërteton në tërësi gjendjen faktike dhe atë në bazë të deklaratës të dëshmitarëve dhe atë të dëshmitarit Z. K., i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 29.09.2015 në mënyrë kronologjike përshkruan të gjitha veprimet që i ka ndërmarr si polic hetues që nga dita kur rastin në polici e ka paraqitur i dëmtuari H. K.1 me datë 03.02.2015, dhe me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve për të gjitha mesazhet të dërguara të dëmtuarit H. K.1 me anë të numrit +386 43 8xx xxx. Është vërtetuar në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat të cilat i ka ofruar telefonia e mobileve IPKO, ku është konstatuar që nga numri i cekur nga i cili janë dërguar mesazhet – SMS të dëmtuarit ka pasur tre ditë dalje të mesazheve dhe me këto tre ditë të njëjtat mesazhe janë dërguar në telefonin e këtu të dëmtuarit. Pos këtyre tre mesazheve nuk ka pasur asnjë telefonat tjetër nga numri i cekur. Pas kësaj nga zyrtarët e telefonisë mobile është kërkuar identifikimi i IMEI me numrin identifikues të telefonit ku ka qenë kartela me numrin +386 43 8xx xxx, dhe nga të njëjtit është konstatuar që në këtë telefon kanë qenë dy numra të telefonit dhe atë numri i telefonit + 386 43 8xx xxx të telefonisë mobile Zogu dhe numri + 386 49 4xx xxx të telefonisë mobile IPKO, e po ashtu nga zyrtarët e telefonisë mobile IPKO është konstatuar që numrin e kompanisë telefonike mobile IPKO të vendosur në këtë telefon, e ka blerë në kompaninë IPKO i akuzuari H. K. Sa i përket kësaj deklaratë, e njëjta mund të vërtetohet edhe në bazë të veprimeve tjera të ndërmarra nga ana zyrtarëve policor në momentin e paraqitjes të mesazheve gjegjësisht kanosjes në telefonin e të dëmtuarit, dhe atë në drejtim të vërtetimit të saktë që numrin e telefonit të kompanisë Zog Mobile nga i cili janë dërguar mesazhet me përmbajtje të kanosjes në telefonin e të dëmtuarit H.1 kanë të bëjnë me faktin që numri i telefonit të cekur i ka takuar dhe ka qenë në posedim të akuzuarit, ngase në bazë të numrit të IMEI ku ka qenë i vendosur numri i telefonit të kompanisë IPKO, në tërësi përputhet me faktin që numri i njëjtë nga i cili janë dërguar mesazhet të dëmtuarit, ka qenë i vendosur në të njëjtin telefon edhe numri i kompanisë të telefonisë mobile

IPKO, e nga informata e zyrtarëve të kompanisë IPKO rrjedh që numrin + 386 49 4xx xxx, e ka blerë këtu i akuzuari.

Sa i përket informacioneve të tjera, nga kompania IPKO, e cila sipas dëshmisë të zyrtarit të ndërmarrjes IPKO, F. Sh., të njëjtit gjatë afarizmit të tyre si telefoni mobile kemi si operator të telefonisë mobile, gjatë afarizmit tonë kemi marrëveshje me anë të kontratave të cilat na shërbejnë për furnizimin e kompanive të ndryshme me numrat telefonik për shitje të të njëjtëve. Në këtë mënyrë si kompani të telefonisë mobile kanë furnizuar edhe T. H. G. SHPK, me seli në fshatin Ll. Komuna e Graçanicës, me një numër të konsiderueshëm të numrave telefonik dhe i njëjti ka pasur të drejtë që numrat që ne japim në disponim, kanë pasur të drejtë gjatë afarizmit të tij që këta numra të ju dorëzoj në disponim edhe distributorëve tjerë, andaj në këtë rast, në rastin konkret numri i telefonit + 386 43 8xx xxx gjatë regjistrimit të numrave me hyrje 043, ne kemi ardhur në përfundim dhe për këtë edhe kemi informuar me shkrim në bazë të raportit të datës 28.09.2015 që ky numër është shitur në pikën e shitjes DPT “E. A.”, në qytetin e Suharekës.

Më gjerësisht edhe dëshmitari I. T. në deklaratën e vet përshkruan në mënyrë të thjeshtë edhe raportin e hartografisë për numrin + 386 43 8xx xxx, dhe ate për periudhën prej datës 26.01.2015 gjer në datën 22.02.2015, ku në mënyrë detale thekson që SMS-at në numrin 044 1xx xxx, numër ky i të dëmtuarit, janë dërguar nga telefonat ku sipas hartografisë janë vendet – celulat që kanë mbuluar pjesën hyrëse të fshatit M., fshatit S., një pjesë të fshatit Sa. dhe të fshatit D. të Komunës së Suharekës, dhe ate për të gjitha mesazhet që janë dërguar me datë 02.02.2015, 03.02.2015 dhe 04.02.2015, ndërsa numri tek i cili janë dërguar këto SMS-a, është i të dëmtuarit H. K.1.

Në deklaratën e vet dëshmitarja N. B. deklaron që është pronare e marketit “E. A.”, në fshatin S., në të cilin lokal shet numra të telefonisë mobile IPKO dhe mbushje edhe të telefonisë mobile IPKO dhe VALA dhe se në muajin janar ka pasur në posedim edhe numra të telefonisë mobile ZOG Mobile, zyrtarët e të cilës e kanë furnizuar duke i sjell diku rreth 30 numra, për të cilat në fillim i ka shënuar të gjithë personat me emra dhe mbiemra

Ndërsa sa i përket deklaratës të akuzuarit se i njëjti deklaron që nuk e ka pasur në posedim fare telefonin me numër +386 43 8xx xxx, gjykata nuk ja fali fare besimin, ngase qëllimi i të njëjtit si për faktin e cekur dhe po ashtu edhe gjatë tërë deklaratës të tij të dhënë në mbrojtjen e vet, sipas mendimit e gjykatës është vetëm shmangia nga përgjegjësia penale dhe vepra penale e cila i vihet në barë, ngase në bazë të provave të cekura të cilave gjykata në tërësi ja fali besimin, dhe ate deklaratës së dëshmitarit zyrtarit policor Z. K., dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e zyrtarëve policor për gjetjen e personit i cili i ka dërguar SMS me përmbajtje të kanosjes të dëmtuarit, ka rezultuar me vërtetimin e gjendjes të plotë faktike ku është konstatuar që numri i telefonit të akuzuarit i cili të njëjtin e ka pasur në posedim, dhe ate të njëjtin e ka humbur sipas deklaratës së akuzuarit, dhe se deklarata e tij që nuk i kujtohet ku e ka humbur numrin e telefonit nga i cili janë dërguar mesazhet të dëmtuarit, e po ashtu edhe numri i telefonit të kompanisë të telefonisë mobile IPKO dhe ate + 386 49 4xx xxx, në bazë të numrit të IMEI xxx, është konstatuar që janë shfrytëzuar në aparat telefonik të dy kartelat dhe ate të kompanisë Zog Mobile +386 43 8xx xxx., si dhe të kompanisë telefonisë mobile IPKO i cekur më lartë, e i cili aparat telefonik ka qenë pronë e të akuzuarit, e të cilat sipas deklaratës të akuzuarit i njëjti deklaron që nuk i kujtohen ku i kanë humbur këtu dy numra të cilat pretendohet që i ka pasur në dispozicion dhe në posedim, e po ashtu sipas deklaratës së tij të njëjtit i kanë

humbur së bashku me aparatën e telefonit. Gjykata konsideron dhe vjen në përfundim që duke pasur parasysh një deklaratë të tillë, si dhe faktin që i njëjti gjatë deklaratës së tij tenton që me çdo kusht të shmangët nga përgjegjësia, gjykata vjen në përfundim që një deklaratë të tillë e ka qëllimin vetëm lirim nga akuza të vetë të akuzuarit. Po ashtu gjykata në tërësi ja fali besimin deklaratave të dëshmitarëve dhe të dëmtuarit, ngase deklaratat e tyre në tërësi janë të përputhshme në mes veti, dhe të njëjtat janë në harmoni në mes veti, ndërsa sa i përket këtyre deklaratave, të njëjtat përputhen edhe me provat materiale gjegjësisht raportet e kompanisë IPKO, dhe raportet të informacioneve të telefonisë mobile, e po ashtu edhe në bazë të foto dokumentacionit. Andaj gjykata pas analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha provave të cekura më lart veç e veç dhe të gjithat së bashku, si dhe pas vlerësimit të të njëjtave, nga të cekurat ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-/ës, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj sipas ligjit, duke vërtetuar përgjegjësin e tij penal juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë përmbajtjen e mesazheve të pranuar në numrin e telefonit të dëmtuarit, shkaktimin e ankthit dhe frikës në nivel të lartë e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, shprehja e keq ardhjes nga ana e të akuzuarit për të dëmtuarin, komform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i katër fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 4 (katër) muajve, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1208/2015 me datë 04.12.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.